

KËRKESË

Tiranë, më 18 shkurt 2021

Drejtuar: Z. Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
Znj. Vasilika Hysi, Zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë
Z. Ulsi Manja, Kryetar i Komisionit për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Z. Muslim Murrizi, Zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryetar i Grupit Parlamentar “Demokrat”
Z. Taulant Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Z. Nimet Musaj, Kryetar i Grupit Parlamentar “I pavarur”
Z. Edmond Stojku, Kryetar i Grupit Parlamentar “Demokraci dhe drejtësi”

OBJEKTI: Kërkesë për të ushtruar nismën ligjvënëse për projektligjin "Për paditë kolektive"

KËRKUESI: Grup i organizatave jofitimprurëse

I nderuar Kryetar i Kuvendit, Z. Ruçi,

Të nderuar Deputetë,

Duke shprehur konsideratën më të lartë dhe kënaqësinë tonë për bashkëpunimin e deritanishëm me Kuvendin e Shqipërisë, ju parashtojme kërkesën tonë si më poshtë vijon:

Ne, një grup organizatash jofitimprurëse të shoqërisë civile në Shqipëri, me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, kemi ndërmarrë nismën për hartimin dhe propozimin e projektligjit “Për paditë kolektive”.

Ky projektligj synon të krijojë një mjet të ri ligjor, “padinë kolektive”, i cili lehtëson aksesin e qytetarëve në procesin gjyqësor dhe ndalon sjelljen e paligjshme nga operatorë të ndryshëm, siç mund të jenë subjektet që veprojnë në fushën e industrisë, telekomunikacionit, tregtisë, shërbimeve, etj.

Padia kolektive përbën një mekanizëm procedural të posaçëm, e cila aktualisht, nuk është parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile ose nga ndonjë ligj tjetër në RSH. Miratimi i ligjit “Për padinë kolektive” do të sillte dobi për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve dhe grupeve të tyre. Ai do të mundësonte ndalimin e shkeljeve dhe cenimeve të paligjshme civile e konsumatore,

ekonomike e mjedisore, shkeljet në marrëdhëniet e punës si dhe kompensimin e qytetarëve për dëmin e pësuar.

Ky projektligj është hartuar mbi bazën e “*Direktivës së Bashkimit Evropian 2020/1828 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 Nëntorit 2020 për paditë përfaqësuese për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve dhe shfuqizimin e Direktivës 2009/22/EC*”, duke u përjasur plotësisht me të. Për hartimin e këtij projektligji, ekspertët kanë mbajtur në konsideratë edhe përvojat pozitive të vendeve të tjera që po zbatojnë një ligj të ngjashëm.

Miratimi i tij do të sillte dobi edhe në ekonominë gjyqësore, si dhe në efektivitetin e gjykimit të padive kolektive, për të parashtruar përpara gjykatës pretendimet e një grupi personash në interesin e tyre të përbashkët.

Projektligji nuk sjell rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe nuk pakëson të ardhurat.

Ne, si organizata të shoqërisë civile kemi organizuar një seri aktivitete informuese e konsultuese, në të cilat kanë marrë pjesë grupe interesi, studentë, organizata të shoqërisë civile dhe profesorë të së drejtës. Anëtarët e grupit të punës kanë reflektuar propozimet e adresuara për përmirësimin e përmbajtjes së projektligjit. Të gjithë pjesëmarrësit e kanë konsideruar këtë projektligj si mjaft të dobishëm për shoqërinë shqiptare.

Për sa më sipër, në pamundësi për të krijuar grumbullime për shkak të pengesave të krijuara prej pandemisë, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për të ushtruar nismën ligjvënëse, si e drejtë kushtetuese për çdonjërin prej deputetëve, si dhe për të kryer procedurat kushtetuese e ligjore për miratimin e këtij projektligji. Përmes kësaj kërkesë, shprehim gjithashtu gatishmërinë tonë për çdo komunikim të mëtejshëm për shpjegimin e përmbajtjes së projektligjit, si dhe bashkëpunimin tonë në procesin e njoftimit, konsultimit apo diskutimit të tij, në procedurat që ju do të ndiqni.

Bashkëngjitur kërkesës, lutemi gjeni projektligjin “Për paditë kolektive”, si dhe relacionin shpjegues.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicionin tuaj,

Për komunikime më të detajuara, mund të kontaktoni drejtpërdrejtë me dy organizatat anëtare të komitetit drejtues të nismës:

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, E-mail avokatore2@yahoo.com, dhe

Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim EDEN. E-mail: eden@eden-al.org

Me respekt,

- 1 Agjencia e Demokracisë Vendore në Shqipëri, LDA Albania, Vlorë
- 2 Akademia e Studimeve Politike
- 3 All Green Center
- 4 Amoro-drom
- 5 Center for Bridging Communities
- 6 Civil Rights Defenders
- 7 ECO Partners for Sustainable Development
- 8 Euro Partners Development
- 9 European Law Students' Association Albania, ELSA
- 10 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
- 11 Forumi i Politikave të Integritimit – EU Policy Hub
- 12 Forumi Shqiptar Social Ekonomik, ASET
- 13 Horizont EU
- 14 Instituti Agenda
- 15 Instituti për Projektim dhe Menaxhim Mjedisor, EDMI
- 16 Instituti për Studime Publike dhe Ligjore
- 17 Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale, Qendra A.L.T.R.I
- 18 Instituti Shqiptar për Zhvillim Politikash
- 19 Klubi Ekologjik Elbasan, KEE
- 20 Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- 21 Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome
- 22 Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem
- 23 Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
- 24 Milieukontakt Shqipëri
- 25 Në dobi të Gruas Shqiptare
- 26 North Green Association
- 27 Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
- 28 Organizata "Në familje për familjen"
- 29 Organizata "Të Ndryshëm dhe Të Barabartë"
- 30 Organizata Build Green Group
- 31 Organizata Drejtësi Sociale
- 32 Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
- 33 Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore, PMSM
- 34 Qendra "Konsumatori Shqiptar"
- 35 Qendra Assist Albania
- 36 Qendra e Informacionit Aarhus Shkoder

- 37 Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale, QKGSHS
- 38 Qendra Europiane
- 39 Qendra Gratë në Shërbim Publik
- 40 Qendra Grupimi Ekolevizja
- 41 Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim, EPER
- 42 Qendra Mjedisore për Studime dhe Zbatime, QMSZ
- 43 Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim, EDEN
- 44 Qendra për Advokim Social
- 45 Qendra për Aksion Komunitar
- 46 Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP
- 47 Qendra për Fuqizim dhe Organizim Komunitar
- 48 Qendra për Gazetari Cilësore
- 49 Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri, EcoAlbania
- 50 Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
- 51 Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, PPNEA
- 52 Qendra Për të Drejtat e Gruas Rome
- 53 Qendra për të Drejtat në Pune
- 54 Qendra për Zhvillim Komunitar Sot për të Ardhmen
- 55 Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale
- 56 Qendra Res Publica
- 57 Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
- 58 Qendra Shqiptare për Qeverisje Mjedisore, ACEG
- 59 Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes, ACFD
- 60 Qendra T'Reja
- 61 Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci
- 62 Rromano Kham
- 63 Shoqata e Bujqësisë Organike
- 64 Shoqata Egnatia
- 65 Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë, AOS
- 66 Shoqata për mbrojtje të jetës dhe ekosistemit përreth fabrikës së çimentos Titan – Burizan
- 67 Shoqata Together for Life
- 68 Shoqata Well Point
- 69 Të gjithë së Bashku për Integrimin e Romëve
- 70 Tirana Legal Aid Society, TLAS
- 71 Ushten
- 72 Voice of Roma
73. CR PARTNERS (Zyrë Ligjore)